



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 22
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 18 korrik 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Drita Millaku, Bekim Haxhiu dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina dhe Fikrim Damka.

I ftuar: z. Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pjesëmarrës tjerë: Drin Haraçia, MPMS, Mentor Tershnjaku, MPMS, Bahri Xhaferi, MPMS, Minire Begaj, MPMS, Gresa Maxhuni-KDI, Vahide Morina - Radio Kosova, Arbnora Luta-KTV, Anita Shabani dhe Fisnik Galani- HANDIKOS.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica**
 - Zbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
 - Zbatimi i Ligjit për personat e verbër;
 - Zbatimi i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
 - Funksionimi i Këshillit Ekonomiko Social;
 - Rrezikshmëria në punë;
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

4. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica

- Zbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Zbatimi i Ligjit për personat e verbër;
- Zbatimi i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
- Funksionimi i Këshillit Ekonomiko Social;
- Rrezikshmëria në punë;

Kryetarja, tha se kemi ftuar ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të raportojë para Komisionit,. Në lidhje me zbatimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, zbatimin e Ligjit për personat e verbër, zbatimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, funksionimi i Këshillit Ekonomiko Social dhe për rrezikshmërinë në punë. Çka keni bërë në këtë drejtim ju si Ministri? Sa keni arritur t'i përmbushni objektivat dhe planin që keni për të ardhmen?

Skender Reçica, ministër i MPMS-ë, në lidhje me Zbatimi i Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, tha se Ministria së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerrë disa udhëzime administrative. Sfidë për zbatimin e këtij ligji mbetet punësimi i personave me aftësi të kufizuara. Ai tha se kanë 443 punëkërkues me aftësi të kufizuar.

Reçica tha se Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti është aprovuar në vitin 2014 dhe i njëjti është në zbatim. Ai përmendi edhe udhëzimet administrative të cilat ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji. Ka shumë probleme në zbatimin e këtij ligji dhe se janë duke punuar në zbatimin sa më të mirë të tij.

Për Këshillin Ekonomiko Social, ai tha që me të marrë mandatin ka rifunksionalizuar të gjitha trupat e këtij Këshilli.

Për rrezikshmërinë në punë, ai tha që Ministria ka marrë një sërë masash ligjore për parandalimin dhe eliminimin e aksidenteve në punë. Në bazë të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, kanë miratuar 19 akte nënligjore, të cilat janë të përafuara me 24 direktiva të BE-së.

Kryetarja, pyeti se kur do të ketë sanksione për organizatat të cilat nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuar dhe se pyeti se pse familjarëve të dëshmorëve ju ka ndërprerë pensioni kontributdhënës.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, në lidhje me rrezikshmërinë në punë, tha që numri i inspektorëve është i vogël dhe duhet të ketë sanksione më të mëdha për bizneset. Ajo pyeti ministrin, se çfarë masa kanë ndërmarrë për bizneset ku ka pasur aksidente me fatalitet.

Enver Hoti, tha se nuk ndjehet mirë që në Ministrinë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë vetëm 5 persona me aftësi të kufizuar dhe se është e kotë të kërkojmë prej organizatave tjera që të punësojnë persona me aftësi të kufizuar, kur ne vet si institucione nuk e bëjmë këtë.

Ai pyeti se çka është duke ndodhur me propozimin e Këshillit Ekonomiko Social, në lidhje me pagën minimale, kurse pyeti edhe për kontributet në vitet '90'-'98, për punëtorët të cilët nuk i gëzojnë këto kontribute si kur do të ndodh reforma për skemat pensionale.

Time Kadrijaj, pyeti se pse Ligji për të Verbrit, kur dërgohet në Kuvend trajtohet nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut e jo nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Bekim Haxhiu, kërkoi sqarim nga Ministri për ligjin dhe kërkoi të bëhet urgjent plotësimi dhe ndryshimi i ligjit, të nenit 8, të Ligjit për personat kontributdhënës. Ai, gjithashtu inkurajoi që skemat për personat me aftësi të kufizuara të jenë brenda një ligji.

Drita Millaku, tha se përveç në kompanitë private, rrezikshmëria në punë ekziston edhe në institucionet publike, si te Policia e Kosovës. Për skemat sociale, ajo tha se ligji nuk po zbatohet aty ku duhet dhe zbatohet.

Millaku përmendi edhe problemin e numrit të vogël të inspektorëve, dhe shtoi se puna e Inspektoratit Komunal, nuk ja pamundëson punën që mund ta kryej Inspektorati Qendror.

Kryetarja, pyeti ministrin se a bashkëpunoni dhe a i ftoni OJQ-të në Këshillin Ekonomiko Social. Ajo tha se ka informata se është dënuar një inspektor dhe duam ta dimë se a është kthyer në vendin e punës apo jo.

Skender Reçica, tha se nuk jemi të kënaqur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ai tha që për personat që sipas ligjit nuk punësojnë personat me aftësi të kufizuara, do të sanksionohen sipas ligjit. Lidhur me pensionet e dyfishta, ai tha që kjo është një padrejtësi që iu bëhet qytetarëve tonë. Ai citoi dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë kriterin për 15 vite përvojë pune dhe se ai është i obliguar që ti zbatojë këto norma ligjore dhe se vetëm me reformë kjo gjë mund të eliminohet. Deri tash, nuk u arrit që të bëhet kjo reformë.

Në lidhje me pyetjen e inspektorit të dënuar, ai tha ende nuk e ka informatën e saktë se si ka vendosur gjykata për këtë rast, kurse në lidhje me OJQ-të, nuk i ftojmë, por ato mund të marrin pjesë në Këshill.

Bekim Haxhiu, pyeti ministrin se a e kanë ndërmend ta ndryshojnë këtë ligj sepse në të kundërtën, ne si Komision do të marrim këtë iniciativë.

Skender Reçica, tha se e mirëpret iniciativën për këtë çështje. Ai gjithashtu tha se edhe Ligji i Punës, ka pasur zbrazësi dhe mangësi dhe jo rastësisht ne e kemi proceduar Ligjin e ri të punës. Në lidhje me rrezikshmërinë në punë, ai tha se ka trashëguar një numër të inspektorëve dhe brenda vitit 2019, do ta arrijë kuotën e rekomanduar nga Komisioni Evropian. Ne jemi në procedurë të vazhdimit të shtimit të numrit të inspektorëve. Ligjin për Inspektorat e kemi kaluar në Qeveri.

Në lidhje me shpërndarjen e pensioneve përmes Postës, ai tha që nuk do të shkoj një kohë e gjatë që do të ketë veprime konkrete për këtë çështje.

Kryetarja, tha që do ta keni edhe më tutje mbështetjen tonë dhe beson që bashkëpunimi do të vazhdojë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU

